

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6197
E martë, 22 dhjetor 2020
çmimi 0.40

Qeveria miraton
Strategjinë Kundër
Korrupsionit për dy
vjetët e ardhshëm | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA KUSHTETUESE RRËZON QEVERINË HOTI, VENDI SHKON NË ZGJEDHJE

Gjykata Kushtetuese ka nxjerr aktgjykim pro kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje për shpalljen të pavlefshëm votimin në Kuvendin e

Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë Hoti më 3 qershor, pasi për këtë qeveri kishte votuar edhe deputeti Etëm Arifi, i cili kishte një aktgjykim

përfundimtar nga Gjykata e Apelit. Pas këtij aktgjykimi të Kushtetueses pritet që vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme. | FAQE 2-3

FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMET SALIHU, PROFESOR I TË DREJTËS PENALE | FAQE 4-5



URGJENTISHT TË RITHEMELOHET INSTITUTI PËR HULUMTIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

Profesori i të Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka thënë se Kosova është vonuar për rithemelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se rithemelimi i këtij instituti është dashur të bëhet brenda tre muajve. Ky institut ishte

themeluar në vitin 2011, por me vendimin e Qeverisë së Kosovës është mbyllur në vitin 2018. Ai ka thënë se vendimi për mbylljen e këtij instituti ishte absurd. Salihu ka thënë se në këtë institut nuk duhet të punësohen individë me lidhje familjare. "Aty duhet të punësohen ekspertë: juristë, ekonomistë dhe

psikologë", ka thënë Salihu, duke shtuar se duhet të punohet intensivisht për evidentimin e të gjitha krimeve që janë kryer nga forcat paramilitare, ushtarake dhe policore serbe. Ai ka theksuar se këto krime që ka bërë Serbia duhet të dokumentohen dhe të botohen në libra në gjuhën shqipe dhe angleze

25 ZYRTARË TË MINISTRISË SË JASHTME REKOMANDOHET TË MARRIN GRADË DIPLOMATIKE



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

FEDERATE E
FUTBOLLIT E KOSOVËS
Kampioni
Internet Website,
Marketing...

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

GOZHDA E VARUR
NË MUR... F. 11

Nga Bedri
ISLAMI



MUNGESA E BASHKËPUNIMIT
POZITË - OPOZITË PO I BËN
JOFUNKSIONALE INSTITUCIONET
E KOSOVËS F. 6

KMDLNJ

AKTUALE

SHQIPËRIA NDALON FLUTURIMET
ME BRITANINË E MADHE F. 2

HOTI: JANARI ËSHTË VONË PËR
ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT F. 5



EKONOMI

TRUSTI NIS EKZEKUTIMIN E
MJETEVE TË 10-PËRQINDËSHIT F. 8

EKONOMIA MBIJETOI PËR TË
MOS SHKUAR NË KOLAPS F. 8

SPORT

ME MERITË JEMI KAMPIONË
VJESHTORË F. 12

Gjykata Kushtetuese rrëzon Qeverinë Hoti, vendi shkon në zgjedhje

PRISHTINË, MË 21 DHJETOR - Gjykata Kushtetuese ka nxjerr aktgjykim pro kërkesës së Lëvizjes Vetëvendosje për shpalljen të pavlefshëm votimin në Kuvendin e Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë Hoti më 3 qershor, pasi për këtë qeveri kishte votuar edhe deputeti Etem Arifi, i cili kishte një aktgjykim përfundimtar nga Gjykata e Apelit.

Pas këtij aktgjykimi të Kushtetueses pritet që vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme.

Ky është vendimi i plotë i Gjykata Kushtetuese

Në seancën shqyrtuese të mbajtur më 21 dhjetor 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shqyrtoi kërkesën: 1. KO 95/20. Më poshtë mund të lexoni përmbledhjen e shkurtër të vendimit (teksti i plotë i vendimit do t'u dorëzohet palëve, do të publikohet në ueb-faqen e Gjykatës dhe në Gazetën Zyrtare gjatë ditëve në vijim):

1. Lënda: KO 95/20

Parashtrues: Liburn Aliu dhe 16 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Objekt i çështjes së kërkesës ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, të 3 qershorit 2020, për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të cilin pala parashtruese pretendonte se nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me

nënparagrafin 6 të paragrafit 3, të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kërkesa bazohej në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese, si dhe në rregullin 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese.

PËRFUNDIME

1. Me datat 28 mars dhe 20 gusht 2019, Etem Arifi ishte dënuar me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, me një vit e tre muaj burgim. Më 6 tetor 2019, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Etem Arifi kandidoi dhe u zgjodh deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më 27 nëntor 2019, KQZ certifikoi rezultatin e zgjedhjeve dhe në listën e deputetëve të certifikuar ishte edhe Etem Arifi. Më 26 dhjetor 2019, u mbajt mbledhja konstituive e Kuvendit ku u konfirmua mandati i Etem Arifit. Që nga ajo kohë, Etem Arifi vazhdoi të ushtronte funksionin e deputetit, edhe pse ndaj tij rëndonte një dënim gjyqësor i formës së prerë, për një vepër penale, me një vit e tre muaj burgim.

2. Në këtë kërkesë kushtetuese, 17 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestuan kushtetutshmërinë e Vendimit të

Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07/V-014, për zgjedhjen e Qeverisë, të nxjerrë më 3 qershor 2020. Parashtruesit pretendojnë se Vendimi në fjalë është në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë], në lidhje me nënparagrafin 6 të paragrafit 3 të nenit 70 [Mandati i Deputetëve] të Kushtetutës. Kjo sepse, sipas parashtruesve, në procedurën e votimit të Vendimit të kontestuar ka marrë pjesë edhe Etem Arifi, vota e të cilit ishte e pavlefshme për shkak të dënimit të tij me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

3. Gjykata vlerëson se, çështja themelore që ngërthen kjo kërkesë është se a kishte pasur mandat të vlefshëm Etem Arifi në kohën e nxjerrjes në Kuvend të Vendimit të kontestuar për zgjedhjen e Qeverisë (në votimin e të cilit ai kishte marrë pjesë).

4. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata mori parasysh: përgjigjet e dorëzuara nga shtetet anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, qëndrimet e Komisionit të Venecias; si dhe praktikën e mëhershme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për situata të ngjashme.

5. Për sa i përket dispozitave kushtetuese dhe ligjore në Republikën e Kosovës, që i japin përgjigje çështjeve të ngritura nga kjo kërkesë, Gjykata gjeti se:

– Neni 71.1 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 29.1(q) të

Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcakton se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhjet për Kuvend, nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit;

– neni 70.3 (6) i Kushtetutës përcakton se mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm nëse ai/ajo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë, me një ose më shumë vite burgim. Ky përcaktim kushtetues përforcohet edhe me nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, nenin 112.1.a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 25.1.d të Rregullores së Kuvendit;

6. Gjykata konsideron se, për sa i përket të drejtës për kandidim në zgjedhje parlamentare, nenet 45, 55 dhe 71.1 të Kushtetutës duhet lexuar në mënyrë të ndërlidhur. Kështu, neni 45 i Kushtetutës flet përgjithësisht për të drejtat zgjedhore, duke përcaktuar në mënyrë të përgjithësuar se ato mund të kufizohen me vendime gjyqësore, kurse neni 55 përcakton kushtet kumulative në bazë të të cilave mund të kufizohen të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë. Ndërsa neni 71 i Kushtetutës – i cili flet ekskluzivisht për “kualifikimet” për të kandiduar për deputet të Kuvendit – përcakton se secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet. Këto “kriteret ligjore”, të

cilave iu referohet neni 71 i Kushtetutës, i përcakton Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili në nenin 29.1 (q) thekson qartë dhe shprehimisht se asnjë person nuk mund të jetë kandidat për deputet për zgjedhje për Kuvend, nëse është dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë në tri vitet e fundit. Ky përcaktim kushtetues dhe ligjor është në linjë edhe me praktikën që ndiqet nga shumë vende demokratike, siç vërehet edhe nga dokumentet përkatëse të Komisionit të Venecias, si dhe nga përgjigjet e vendeve anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias.

7. Gjykata thekson se normat e mësipërme kushtetuese dhe ligjore, të cilat kanë të bëjnë me p a m u n d ë s i n ë (papërshtatshmërinë) për t'u kandiduar për deputet në zgjedhjet e përgjithshme, si dhe me mbarimin apo pavlefshmërinë e mandatit të deputetit, si pasojë e dënimit me burgim për kryerjen e veprave penale, nuk duhen parë si qëllim në vetvete. Në thelb, këto norma nuk kanë synim parësor ndëshkimin e individëve të caktuar duke ua pamundësuar atyre ushtrimin e funksionit të deputetit, por kanë si qëllim themelor mbrojtjen e integritetit kushtetues dhe besueshmërisë qytetare në organin ligdhënës, si shtyllë e demokracisë parlamentare.

8. Gjykata konsideron se besueshmëria qytetare në Kuvendin e Republikës së Kosovës cenohet nëse – pavarësisht



ndalesave që vë nën 71 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme – lejohet që mandatin e deputetit ta fitoj dhe ta ushtroj një person që është dënuar për veprë penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë të vlefshëm në Republikën e Kosovës.

9. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje Raportin e Komisionit të Venecias, i cili thekson se “ligjshmëria është element i Sundimit të Ligjit dhe nënkupton që ligji duhet të respektohet nga individët dhe autoritetet. Ushtrimi i funksionit politik nga personat të cilët kanë shkelur ligjin në mënyrë serioze vendos në rrezik zbatimin e këtij parimit [sundimit të ligjit], që është njëri nga parakushtet e demokracisë, dhe për këtë arsye rrezikon natyrën demokratike të shtetit”. (Shih Raportin e Komisionit të Venecias për Përgjithshme të Kryerësve të Veprave të Paligjshme nga Parlamenti, CDL-EL(2015)026, i 23 nëntorit 2018, paragrafi 168).

10. Në këtë frymë, Gjykata vlerëson se është kërkesë e qartë kushtetuese e mishëruar në nenin 71.1 në ndërlidhje me nenin 70.3 (6) të Kushtetutës, se është e papajtueshme me Kushtetutën që një person ta fitoj dhe mbaj mandatin e deputetit nëse është i dënuar për veprë penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë, siç është përcaktuar me këto dispozita. Kjo kërkesë përforcohet me nenet 29 dhe 112 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nenin 8.1.6 të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit.

11. Më tutje, Gjykata thekson se fakti që neni 70.3 (6) i Kushtetutës, neni 8.1.6 i Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe neni 112.1 (a) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i referohen dënimit të deputetit (pra dënimit pasi ai ta ketë fituar mandatin), është reflektim i prezumimit se neni 29.1 (q) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili mbështetet në nenin 71.1 të Kushtetutës, nuk lejon që një person i dënuar me burgim gjatë tri viteve të fundit para zgjedhjeve të kandidoj për deputet dhe të fitoj mandatin e deputetit.

12. Rrjedhimisht, duke u bazuar në gjuhën e qartë të nenit 71.1 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe nënparagrafit 6 të paragrafit 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata konsideron se asnjë person nuk mund të fitoj dhe mbaj mandat të vlefshëm të deputetit nëse është i dënuar për veprë penale sikurse parashihet me këto dispozita, me vendim gjyqësor të formës së prerë, nëse kundër tij/saj ka një vendim dënues që është në fuqi në Republikën e Kosovës.

13. Gjykata vëren sqarimin e KQZ-së se sipas Aktgjykimit AA-Uzh.nr.16/2017, të 19 shtatorit 2017 të Gjykatës Supreme, “askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje, nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që don të thotë, se kandidati duhet me vendim të formës së prerë, të shpallet fajtor dhe gjykata, t’i ketë shqiptuar dënimin plotësues “heqjen e të drejtës për tu zgjedhur”.

14. Megjithatë, Gjykata konsideron se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk kërkon që personave të dënuar për vepra penale t’iu shqiptohet medoemos si dënim plotësues “heqja e të drejtës për t’u zgjedhur”, në mënyrë që ata të mos lejohen të kandidojnë në zgjedhje parlamentare. Kjo meqë, sipas nenit 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ndër të tjera, parashihen edhe këto dy baza: (i) heqja e të drejtës për të qenë kandidat në zgjedhje me vendim të PZAP-it dhe gjykatës; si dhe (ii) pamundësia për të qenë kandidat për shkak të shpalljes fajtor për një veprë penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri vitet e fundit. Këto janë baza të ndryshme/të ndara që shkaktojnë pamundësinë/papërshtatshmëri në për të qenë kandidat. Gjykata është e mendimit se ky interpretim përputhet edhe me leximin e ndërlidhur të neneve 45, 55 dhe 71 të Kushtetutës.

15. Gjykata konsideron të rëndësishme të vë në dukje se kandidimi në zgjedhje parlamentare i Etem Arifit, zgjedhja e tij si deputet dhe ushtrimi i mandatit të deputetit – të gjitha këto pasi që ai ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim, me vendim gjyqësor të formës së prerë – shpërfaqë ekzistimin e paqartësisë normative dhe të metave serioze në mekanizmat institucional të Republikës së Kosovës, që janë kompetent për të garantuar ligjshmërinë dhe integritetin kushtetues të proceseve zgjedhore dhe veprimtarisë parlamentare. Kjo paqartësi është e dukshme edhe në përgjigjet që janë dhënë nga trupat përkatës të Kuvendit dhe nga KQZ-ja.

16. Në lidhje me këtë, Gjykata potencon nevojën që Kuvendi i Republikës së Kosovës me komisionet e tij, në bashkëveprim me institucionet gjegjëse, duke përfshirë edhe KGJK-në dhe KQZ-në, të qartësojnë dhe konsolidojnë bashkëpunimin ndër-institucional dhe aspektet normative që kanë të bëjnë me kandidimin në zgjedhje parlamentare dhe ushtrimin e mandatit të deputetit, nga ana e personave të dënuar për vepra penale.

17. Kjo është e domosdoshme për të shmangur situatat paradoksale,



nga këndvështrimi kushtetues, ku një person, pasi është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë sikurse parashihet me nenet përkatëse të Kushtetutës dhe ligjeve, i lejohet të kandidojë në zgjedhje parlamentare, të zgjedhet deputet, t’i verifikohet mandati, si dhe të vazhdojë të ushtrojë funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, madje edhe gjatë vuajtjes së dënimit me burgim. Ndërkohë që Kushtetuta dhe ligjet përkatëse vënë barriera të qarta normative për të mos lejuar personat e dënuar me burgim për kryerjen e veprave penale, që të zgjedhën deputet dhe të ushtrojnë mandatin e deputetit.

18. Për sa i përket zgjedhjes së Qeverisë, Gjykata thekson se në mënyrë që Qeveria të zgjedhet, konform paragrafit 3 të nenit 95 të Kushtetutës, “për” Qeverinë duhet të votojnë të paktën gjashtëdhjetë e një (61) deputetë të Kuvendit. Në rastin konkret, sipas dokumenteve zyrtare të Kuvendit, Gjykata vëren se më 3 qershor 2020, gjashtëdhjetë e një (61) deputetë kishin votuar “për” Qeverinë, gjegjësisht për vendimin e kontestuar. Për miratimin e Vendimit të kontestuar kishte votuar edhe Etem Arifi. Pasi Gjykata gjeti se mandati i Etem Arifit kishte qenë i pavlefshëm para votimit të Vendimit të kontestuar, ai Vendim kishte marrë vetëm gjashtëdhjetë (60) vota të vlefshme. Për pasojë, procedura për të zgjedhur Qeverinë nuk është zhvilluar në përputhje me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

19. Gjykata vë në pah se neni 95 i Kushtetutës, siç është interpretuar përmes praktikës së saj gjyqësore, parashih dy tentativa për zgjedhur Qeverinë nga Kuvendi. Në të dyja rastet, Qeveria për t’u konsideruar e zgjedhur duhet të ketë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përkatësisht gjashtëdhjetë e një (61) vota. Nëse as pas tentimit të dytë nuk zgjedhet Qeveria, neni

95.4 i Kushtetutës parashih shpalljen e zgjedhjeve nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.

20. Gjykata rikujton që Qeveria e votuar përmes Vendimit nr. 07/V-014 të Kuvendit të 3 qershorit 2020 është bazuar në Dekretin e Presidentit nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020, të nxjerrë bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, përkatësisht në tentativën e dytë për zgjedhjen e Qeverisë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton interpretimin e dhënë në Aktgjykimin KO72/20 ku kishte theksuar se “zgjedhjet do të jenë të pa evitueshme në rast të dështimit të zgjedhjes së Qeverisë edhe në tentativën e dytë, [...] me ç’rast, bazuar në paragrafin 4 të nenit 95 të Kushtetutës, Presidenti shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre”.

21. Në dritën e kësaj, Gjykata thekson se në rastin konkret vihet në lëvizje paragrafi 4 i nenit 95 të Kushtetutës, sipas të cilit Presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.

22. Gjykata e konsideron të rëndësishme të theksoj se është e vetëdijshme se Etem Arifi ka marrë pjesë edhe në procedura të tjera votuese në Kuvend, edhe pasi ai nuk kishte mandat të vlefshëm. Megjithatë, duke u mbështetur në parimin non ultra petita (“jo përtej kërkesës”), Gjykata kufizohet në vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar më kërkesën e paraqitur para saj, gjegjësisht Vendimit nr.07/V-014, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkitazi me Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Republikës së Kosovës.

23. Gjykata e sheh të nevojshme që të sqarohet po ashtu se, duke u nisur nga parimi i sigurisë juridike, si dhe nga fakti se ky Aktgjykim nuk mund të ketë efekt prapaveprues, vendimet e Qeverisë aktuale mbeten në fuqi, si dhe Qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113, paragrafi 5, të Kushtetutës, neneve 42 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në mbështetje të rregullave 59 (1) dhe 72 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOS

I. TË SHPALLË KËRKESËN TË PRANUESHME;

II. TË KONSTATOJË se, në bazë të nenit 71.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, personi i dënuar për veprë penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tri (3) vitet e fundit, nuk mund të jetë kandidat për deputet e as të fitoj mandat të vlefshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës;

III. TË KONSTATOJË se, Vendimi nr. 07/V-014 i Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës, i 3 qershorit 2020, nuk është në pajtueshmëri me paragrafin 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, sepse Qeveria nuk ka marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

IV. TË KONSTATOJË se, marrë parasysh se Qeveria nuk është zgjedhur sipas paragrafit 3 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, atëherë mbështetur në paragrafin 4 të nenit 95 [Zgjedhja e Qeverisë] të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre;

V. TË KONSTATOJË se, ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe mbështetur në parimin e sigurisë juridike vendimet e Qeverisë mbeten në fuqi, si dhe Qeveria mbetet në detyrë deri në zgjedhjen e Qeverisë së re.

Shqipëria ndalon fluturimet me Britaninë e Madhe




TIRANË, 21 DHJETOR - Shqipëria do t'i ndalojë fluturimet me Britaninë e Madhe dhe të gjithë qytetarët që vijnë nga ky vend edhe përmes rrugëve tokësore, do të detyrohen të izolohen për dy javë. Ministria e Shëndetësisë e Shqipërisë, Ogerta Manastirliu, në një konferencë për media tha se kjo masë është rekomanduar nga komiteti teknik i ekspertëve, pas paraqitjes së një varianti të ri të koronavirusit në Britaninë e

Madhe. "Kemi vendosur pezullimin e fluturimeve me Britaninë e Madhe duke filluar nga ora 06:00 e ditës së martë, më 22 dhjetor, deri më datë 6 janar. Po ashtu, vendoset masa e karantinës së detyrueshme 14-ditore për qytetarët që vijnë nga Britania e Madhe përmes fluturimeve direkte apo rrugëve tokësore", ka thënë Manastirliu. Ministria Manastirliu ka pohuar se për ta shmangur rritjen e rasteve të reja me koronavirus

gjatë festave të fundvitit, kanë vendosur që të ketë kufizime të lëvizjes dhe të aktivitetit të bizneseve të gastronomisë. "Kemi vendosur kufizimin e lëvizjes së popullatës nga ora 20:30 deri në orën 6:00, duke filluar nga data 24 dhjetor deri më 4 janar", ka thënë ajo, duke shtuar se në të njëjtën periudhë do të vlejë edhe kufizimi për punën e bareve, restoranteve dhe lokaleve të tjera që ofrojnë shërbime për klientët.

Ligjvënësit amerikanë pajtohen për paketën e ndihmës ekonomike

WASHINGTON, 21 DHJETOR - Udhëheqësit e Kongresit Amerikan u pajtuan për një paketë prej gati 900 miliardë dollarësh për ta ndihmuar ekonominë e shkatërruar nga pandemia e Covid-19. Pas disa muajsh të negociatave të dështuara, udhëheqësit e Dhomës së Përfaqësuesve dhe të Senatit njoftuan të dielën vonë se kanë arritur marrëveshjen dypalëshe. Legjislacioni është ende duke u shkruar dhe ka gjasa të votohet



sot. Kongresi ka në plan ta kombinojë këtë stimul me një paketë prej 1.4 trilion dollarësh, që duhet miratuar patjetër, për ta financuar qeverinë për vitin fiskal 2021. "Më në fund, kemi një përparim dypartiak që i është dashur vendit", tha udhëheqësi i shumicës republikane në Senat, Mitch McConnell. Kurse udhëheqësi i pakicës demokrate në Senat, Chuck Schumer, ka thënë se më në fund kemi disa lajme të mira

për t'i dhënë popullit amerikan. Marrëveshja vjen në kohën kur pandemia e Covid-19 dhe masat për frenimin e saj kanë ngadalësuar ekonominë, duke lënë miliona amerikanë pa punë. Disa dispozita të një pakete masive të ndihmës, në vlerë prej 2.3 trilionë dollarësh, janë miratuar në mars, por ato kanë skaduar muaj më parë. Marrëveshja e re e ndihmës do të sigurojë 600 dollarë në muaj për shumë individë të papunë.

Partitë dominuese fitojnë zgjedhjet e para në Mostar pas 12 vjetësh

MOSTAR, 21 DHJETOR - Partitë dominuese boshnjake dhe kroate fituan shumicën e votave në zgjedhjet lokale të Mostarit, tregojnë rezultatet paraprake. Zgjedhjet në këtë qytet të Bosnjës u mbajtën të dielën, për herë të parë në 12 vjet. Partitë e vogla, përfshirë Bllokun shumetnik të Bosnjës, fituan po ashtu ulëse në këshillin e qytetit, të përbërë prej 35 anëtarësh. Për udhëheqjen e qytetit, kryebashkiaku i ri do të ketë nevojë për mbështetjen e shumicës prej dy të tretave. Pjesëmarrja në zgjedhje ishte 55 për qind.

Popullsia e Mostarit prej 100 000 banorësh është kryesisht e ndarë midis kroatëve në perëndim dhe boshnjakëve në lindje. Mostari nuk ka mbajtur zgjedhje lokale që nga viti 2008 për shkak të dështimit të autoriteteve për të zbatuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës - të vitit 2010 - i cili ka vlerësuar se struktura e ndarjes së pushtetit të qytetit është anti-kushtetuese dhe se duhet reformë. Në mungesë të zgjedhjeve, partitë dominuese, Partia Boshnjake e Veprimtimit Demokratik (SDA) dhe Bashkimi Demokratik Kroat

(HDZ), kanë qeverisur zonat e tyre me shërbime të ndara, me kompani postare, universitete dhe spitale po ashtu të ndara. Problemi është zgjidhur më 2019, pasi Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dënuar Bosnjën për dështimin e saj për ta ndryshuar Ligjin e Zgjedhjeve dhe për t'i mundësuar zgjedhjet komunale në Mostar. Në atë rast, gjykata ka vendosur në favor të mësueses dhe politikanës së Mostarit, Irma Baralija, e cila, në një proces gjyqësor, ka argumentuar se çështja ligjore e pengon atë të votojë ose të kandidojë në zgjedhjet komunale.



Shtrihet në spital Millorad Dodik



SARAJEVË, 21 DHJETOR - Anëtari i presidencës trepalëshe të Bosnje dhe Hercegovinës, Millorad Dodik, është shtruar në spital për shkak të simptomave të cilat mjekët i përshkruan si mundim dhe

dhimbje stomaku. Qendra Klinike Universitare e Banja Llukës i tha "Radios Evropa e Lirë" se Dodik, 61 vjeç, u shtrua në spital më 21 dhjetor. Duke përshkruar gjendjen e tij shëndetësore si

"të qëndrueshme" dhe "jashtë rrezikut për jetën", mjekët thanë se një procedurë e hollësishme diagnostikuese ishte në proces. Zyra e Dodikut, përmes një

deklarate më 19 dhjetor, tha se ai doli negativ në testin e koronavirusit. Dodik ishte në vetizolim pasi ka pasur kontakt me një person të infektuar me Covid-19 tri ditë më parë.

Vazhdon rindërtimi i kapacitetit diplomatik dhe funksional i Kosovës

25 zyrtarë të Ministrisë së Jashtme rekomandohet të marrin gradë diplomatike



Në funksion të fuqizimit të brendshëm për adresimin e nevojave për zhvillimin dhe profesionalizimin e shërbimit të jashtëm, 25 zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), të cilët nuk kanë pasur gradë diplomatike dhe të cilët i kanë plotësuar kushtet e parapara me dispozitat ligjore, janë rekomanduar për gradim nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë

gradimit dhe rotacionit. Në funksion të fuqizimit të brendshëm për adresimin e nevojave për zhvillimin dhe profesionalizimin e shërbimit të jashtëm, 25 zyrtarë të MPJD-së të cilët nuk kanë pasur gradë diplomatike dhe të cilët i kanë plotësuar kushtet e parapara me dispozitat ligjore janë rekomanduar për gradim nga Komisioni për Grada dhe Disiplinë.

Në kualifikimin profesional, përvojën e punës, njohuritë e gjuhëve të huaja dhe certifikimet e nevojshme për ofrim të shërbimeve konsullore.

Në kuadër të përfundimit të mandatit të rregullt në muajt në vijim do të kthehen për të shërbyer në MPJD rreth 20 diplomatë të cilët do të zëvendësohen nga 20 zyrtarë të MPJD-së të cilët do të shërbejnë në misionet respektive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës nga Uashingtoni e deri në Tokio. Këta zyrtarë kanë fituar përvojën adekuate në MPJD për të shërbyer me sukses në misionet diplomatike dhe konsullore, si dhe sjellin me vete një bagazh diplomatik e përvojë të rëndësishme nga misionet tona

nëpër botë. Këto veprime pashmangshëm po kthejnë normalitetin e nevojshëm në MPJD.

Me këtë rast ministrja Haradinaj-Stublla i uroi zyrtarët e përzgjedhur dhe kërkoi nga ta që të kontribuojnë për fuqizim të shërbimit të jashtëm përmes zbatimit të praktikave më të mira të funksionimit të shërbimit të jashtëm, duke kryer me nder dhe përgjegjësi të lartë detyrat e përcaktuara si dhe duke shërbyer me përkushtim për avancimin e interesit strategjik të Republikës së Kosovës.

Synimi i MPJD-së është që të krijohet një shërbim i jashtëm profesional me qëllim të fuqizimit të punës dhe dinjitetit të anëtarëve të shërbimit të jashtëm.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në vazhdim të angazhimeve për reformë të brendshme dhe fuqizim të kapaciteteve të brendshme të strukturave të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), si dhe prioritetit qeverisës për rishikim

të plotë funksional të shërbimit të jashtëm, po vazhdojnë veprimet konkrete bazuar në dispozitat ligjore me të cilat synohet zhvillimi i resurseve njerëzore dhe operacionale në MPJD. Tanimë rotacioni diplomatik është bërë i rregullt dhe ka filluar kthimi i normalitetit të brendshëm ku janë ndërmarrë veprime konkrete sa i përket

Po ashtu, ka vazhduar me sukses rotacioni i rregullt, sipas konceptit 'një në shërbim, një në ministri' i filluar muaj më parë nga ministrja Meliza Haradinaj - Stublla.

Ky proces ka vazhduar të realizohet në transparencë të plotë, i udhëhequr nga parimi i meritës dhe barazisë, bazuar në

Haxhiu: Po bëhen mashtrime me testime

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bekim Haxhiu, ka thënë se situata me pandeminë Covid-19 vazhdon të jetë shqetësuese. Në një koment publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", ai ka shkruar se, pavarësisht prej faktit që javën e fundit qeveria, duke zvogëluar numrin e testimeve, po përpiket të prezantojë shifra të ulëta të

rasteve pozitive, edhe pse, sipas tij, përqindja e rasteve pozitive është pothuajse çdoherë më e lartë se 25 për qind nga mostra e testuar. "Qeveria duhet të shpjegojë pse më 12.11.2020 janë bërë 2 178 teste dhe nuk është vazhduar me këtë nivel të testimeve, por ka zvogëluar testimin saqë dje u bënë vetëm 1 001 teste. Derisa MSh-ja ka proklamuar se janë siguruar

edhe shtatë aparatura për teste RT PCR, shtu këtu edhe testet e laboratorëve privatë, atëherë përse ky numër i vogël testimeve? Përse po ndodhin këto manipulime me testime pas nëntë muajve pandemi e dhjetë muajve testime për Covid-19? Pse nuk po shfrytëzohen të gjitha kapacitetet për më shumë testime?", ka thënë deputeti Haxhiu.





FLET PËR “EPOKËN E RE”, ISMET SALIHU, PROFESORI I TË DREJTËS PENALE

URGJENTISHT TË RITHEMELOHET INSTITUTI PËR HULUMTIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

Profesori i të Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka thënë se Kosova është vonuar për rithemelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Në intervistën dhënë për gazetën “Epoka e re”, ai ka thënë se rithemelimi i këtij instituti është dashur të bëhet në mënyrë urgjente, brenda tre muajve. Ky institut ishte themeluar në vitin 2011, por me vendimin e Qeverisë së Kosovës është mbyllur në vitin 2018. Ai ka thënë se vendimi për mbylljen e këtij instituti ishte absurd. Salihu ka thënë se në këtë institut nuk duhet të punësohen individë me lidhje familjare. “Aty duhet të punësohen ekspertë: juristë, ekonomistë dhe psikologë”, ka thënë Salihu, duke shtuar se duhet të punohet intensivisht për evidentimin e të gjitha krimeve që janë kryer nga forcat paramilitare, ushtarake dhe policore serbe. Ai ka theksuar se këto krime që ka bërë Serbia duhet të dokumentohen dhe të botohen në libra në gjuhën shqipe dhe angleze

Salihu ka theksuar se është skeptik rreth iniciativës për rithemelimin e këtij instituti. “Nuk është dashur në atë kohë të mbyllet ky institut, edhe pse ka qenë i themeluar me vonesë në vitin 2011. Ky institut ka pasur një staf modest dhe ka pasur shpenzime modeste, po ashtu edhe buxhetin e ka pasur modest. Kemi bërë dhjetë publikime. Tani po bëhen dy vjet qëkur është mbyllur ky institut. Tashmë ka filluar kjo iniciativë për rithemelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, por edhe kjo iniciativë është me vonesë. Unë u kam bërë thirrje deputetëve që ta problematizojnë këtë çështje, që instituti të jetë funksional. Mbyllja e këtij instituti në vitin 2018 ka qenë absurde. Jam skeptik për iniciativën për rithemelimin e këtij instituti”, ka thënë Salihu. Ai këtë skepticizëm e bazon në vonesat që po bëhen për rithemelimin e këtij instituti. “Iniciativa është filluar që gjashtë apo shtatë muaj dhe deri më tani kemi formuar njëfarë grupi i cili ka filluar përgatitjet, e që këto përgatitje do të marrin kohë edhe gjashtë muaj. Derisa të rekrutohet stafi dhe të

stabilizohet ky institut do të shkojë edhe një vjet ose dy vjet. Rithemelimi i institutit është dashur të bëhet në mënyrë urgjente. Është dashur të bëhet brenda tre muajve. Të shpallet një konkurs publik për organogramin dhe për stafin, pra për njerëzit që duhet të angazhohen aty”, ka thënë ai. Salihu ka bërë thirrje që në Institutin për Hulumtimin e Krimeve të mos punësohen individë me lidhje familjare. “Në këtë institut nuk duhet të shkojnë militantë të partive si halla, teze e dajë, qysh kanë bërë deri më tash. Në Institutin për Hulumtimin e Krimeve duhet të punësohen ekspertë, 13 ose 14 veta. Duhet të kenë kushte optimale, në mënyrë që në tri-katër vjetët e ardhshëm të punohet intensivisht për evidentimin e të gjitha krimeve që janë kryer nga forcat paramilitare, ushtarake dhe policore serbe”, ka deklaruar Salihu. Ai ka shtuar se këto krime që ka bërë Serbia duhet të dokumentohen dhe të botohen në libra shqip dhe anglisht. “Këto krime duhet të dokumentohen përmes librave në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Besa, ku është e nevojshme, edhe serbe.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka mbajtur të hënën takimin e parë me grupin punues për përgatitjen e analizës për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Ky institut ishte themeluar në vitin 2011, por me vendimin e Qeverisë së Kosovës, e cila atëkohë drejtohej nga Ramush Haradinaj, është mbyllur në vitin 2018. Ndërkaq të hënën ministri Selimi ka diskutuar me anëtarët e grupit

punues për përgatitjen e analizës për themelimin e mekanizmit për hulumtimin e krimeve të luftës. Duke folur për rëndësinë që do ta ketë Institutin për Hulumtimin e Krimeve, ministri Selimi ka thënë se pas themelimit të këtij instituti do të angazhohen 100 studentë të cilët do të merren me hulumtimin në terren. Ministria e Drejtësisë në tetor të këtij viti kishte riproceduar në Zyrën e Kryeministrit kërkesën për përfshirje në rend të ditës, ku ishte aprovuar propozimi i MD-së për ta themeluar grupin punues për përgatitjen e

analizës për themelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Ky institut në përbërjen e tij pritet të ketë akademikë, profesorë, aktivistë të çështjeve të luftës, familjarë të personave të pagjetur dhe përfaqësues nga Shoqata “Thirrjet e Nënave”. Në lidhje me rithemelimin e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, për gazetën “Epoka e re” ka folur ish-drejtuari i këtij instituti, profesori i të Drejtës Penale, Ismet Salihu. Ai ka thënë se mbyllja e këtij instituti në vitin 2018 ka qenë një vendim absurd.

Bie numri i të infektuarve me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Në Kosovë të hënën janë regjistruar edhe gjashtë të vdekur nga Covid-19. Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShPK), Naser Ramadani, ka thënë në një konferencë për media se rastet e vdekjes janë nga: Prishtina tri raste, Gjilani një rast, Mitrovica dy raste dhe Prizreni një rast. Sipas raportit ditor të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, nga testimi i 990 mostrave janë shënuar si të infektuar me Covid edhe 264 persona. Aktualisht raste aktive janë 11 134, ndërsa nga Covid-19 janë shënuar 205 pacientë. Që nga mesi i muajit mars në Kosovë

janë regjistruar 49 169 të infektuar me Covid, prej të cilëve 1 262 kanë vdekur ndërsa 36 773 janë shënuar.

Edhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, nuk njoftoi për ndonjë masë të re, por bëri thirrje për respektimin e masave aktuale si dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, sidomos në këtë periudhë kur vendi ballafaqohet me fluks të të ardhurve nga diaspora. Samedin Mehmeti, ushtrues i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të policisë, ka thënë se gjatë fundjavës në vend kanë hyrë deri në 20 mijë qytetarë në ditë nga pikat kufitare dhe aeroporti i Prishtinës.



Hoti: Janari është vonë për zgjedhjen e presidentit

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, u ka bërë thirrje partive politike që sa më shpejt të merren vesh për çështjen e presidentit të vendit, duke thënë se "muaji janar është vonë". Kosova është me ushtruese të detyrës të presidentit qëkur Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje nga posti në fillim të nëntorit, për t'u përballur me akuzat për krime lufte në Hagë. Në bazë të Kushtetutës, ushtruesja e detyrës, Vjosa Osmani, mund ta mbajë këtë

pozitë deri në gjashtë muaj. Partitë politike nuk janë pajtuar ende se si të procedojnë këtë çështje. Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila udhëheq qeverinë, insiston në një marrëveshje midis spektrit politik. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e cila është pjesë e koalicionit qeverisës, ka propozuar liderin e saj, Ramush Haradinaj, për president. E partia më e madhe në opozitë, Lëvizja Vetëvendosje, thotë se duhet të mbahen zgjedhje të reja parlamentare dhe pastaj të

zgjidhet presidenti.

Hoti tha se Kushtetuta e Kosovës është e qartë dhe se kjo situatë mund të vazhdojë maksimum për gjashtë muaj. "Por, ne nuk duhet ta presim ditën e fundit. Duhet të kujdesemi që t'i kryejmë punët me kohë, në mënyrë që vendi të mos mbetet pa institucione. Unë besoj se edhe janari është vonë [për zgjidhjen e situatës]", ka thënë Hoti në një konferencë për media në Prishtinë. Sipas Kushtetutës së Kosovës, zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat e votave të të gjithë

deputetëve të Kuvendit.

Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve, të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë. Pastaj, kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve zgjidhet president i Republikës së Kosovës. Nëse në votimin e tretë asnjëri kandidat nuk zgjidhet president, atëherë Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda 45-ditësh.

Gjithashtu, këto krime që janë kryer nga forcat paramilitare, ushtarake dhe policore serbe duhet të botohen edhe formë digjitale. Një profesor i Sarajevës thotë: 'Do të ishte krim tjetër nëse nuk evidentohen ato krime'. Ne e kemi për obligim që të flasim për këto krime që ka bërë Serbia', është shprehur profesori i të Drejtës Penale, Ismet Salihu.

Ai ka thënë se Instituti për Hulumtimin e Krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë duhet të ketë mbështetje maksimale në punën që pret. "Ky institut duhet të ketë mbështetje maksimale. Së pari me kuadro, pastaj me objekte dhe me infrastrukturë tjetër që ka nevojë. Pra, duhet t'i shkohet kësaj pune seriozisht. Është bërë një lëshim dhe vonesë e madhe në këtë drejtim. Sa më shumë që shkon koha, edhe më vështirë do të jetë që të dokumentohen këto krime. Edhe familjarët të cilëve u janë vrarë fëmijët, prindërit, nuk duan tash të flasin, sepse ritraumatizohen. Në këtë institut duhet të ketë të punësuar edhe psikologë, juristë dhe ekonomistë", ka theksuar profesor Salihu.

Ai ka përmendur rastin kur Ali Izbegović, në kohën sa ishte kryetar i Bosnjës, me dekret të veçantë kishte themeluar Institutin për Krime të Luftës, i cili edhe sot ende ekziston. "Në vitin 1991 Ali Izbegović me dekret të veçantë e ka themeluar Institutin për Krime të Luftës. Ai institut ende punon me 14-15 veta. Çdo masakër dhe çdo varrezë masive e ka fotografuar dhe evidentuar. Edhe ne duhet të veprojmë kështu, edhe pse jemi vonuar shumë", ka thënë profesori i të Drejtës Penale, Ismet Salihu.



Policia e Kosovës arrin rezultate pozitive në uljen e krimit

Policia e Kosovës (PK) ka njoftuar se ka arritur rezultate pozitive në uljen e trendit të krimit, përfshirë uljen e veprave penale si grabitjet, vjedhjet dhe vjedhjet e rënda. "Parametrat e matjes së krimit në përgjithësi krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë shënuar rënie. Veprat penale për këtë periudhë kohore kanë shënuar rënie për -6.15 për qind (nga 24 631 në 2019-n, në 23 114 në 2020-n). Edhe rastet (veprat penale plus incidentet e tjera) të iniciuara nga policia kanë shënuar rënie për -6.31 për qind", ka njoftuar policia



alendarik, një analizë gjithëpërfshirëse i është bërë realizimit të planit të punës për 2020. Parametrat e matjes së krimit në përgjithësi, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kanë shënuar rënie. Kështu, veprat penale për këtë periudhë kohore kanë shënuar rënie për -6.15 për qind (nga 24 631 në 2019-n, në 23 114 në 2020-n). Edhe rastet (veprat penale plus incidentet e tjera) të iniciuara nga policia kanë shënuar rënie për -6.31 për qind", ka njoftuar policia. Policia e Kosovës, për realizim të planit të punës, gjatë kësaj periudhe ka

arrestuar 9 715 të dyshuar ose 12.71 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Po sipas këtij njoftimi, numri i personave që janë dërguar në mbajtje është 3 870, ose 9.87 për qind më i lartë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Veprat penale (ato më kryesoret), kundër pasurisë, kanë shënuar një ulje të

ndjeshme. Numri i vjedhjeve ka shënuar ulje, nga 4 131 në 3 492 ose -15.46 për qind. Numri i vjedhjeve të rënda ka shënuar ulje, nga 3 421 në 3 030 ose -11.42 për qind. Dhe numri i rasteve grabitje ka shënuar ulje nga 147 në 127 ose -13.60 për qind", është bërë me dije në këtë njoftim të Policisë së Kosovës. Edhe përkundër uljes së

Reagim i KMDLNj-së

Mungesa e bashkëpunimit pozitë-opozitë po i bën jofunksionale institucionet e Kosovës

Institucionet e Kosovës po kalojnë kohë të vështira për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 që është e përkohshme kurse, në anën tjetër, mungesa e bashkëpunimit midis pozitës dhe opozitës, edhe për çështje të rëndësishme të veçantë për funksionimin e shtetit, përfundimisht po e futë Kosovën në një krizë të thellë institucionale. Ndonëse ishte dhe është interes vital i qytetarëve që sa më shpejt dhe sa më lehtë ta kalojnë pandeminë, si në aspektin shëndetësor ashtu edhe material, ka munguar përkrahja e opozitës për të ndërtuar dhe zbatuar një strategji për luftimin e pandemisë, për më keq opozita e ka përdorur si "mjet lufte" pandeminë për ta diskredituar pozitën dhe për të provokuar zgjedhjet e parakohshme ndonëse Kosova nuk qëndron keq krahasuar me vendet e rajonit në menaxhimin e pandemisë. Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike u votua me një vonesë të pafalshme prej gjashtë muaj e që u përkrah nga PDK-ja kurse nuk u votua nga LV-ja. Lista Serbe po e kërcënon dhe po e shantazhon Qeverinë e Kosovës të merr vendime në kundërshtim me Kushtetutën e



Kosovës, në të kundërtën do ta përkrahë mocionin për rrëzim të qeverisë së kryeministrit Hoti. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, në vend se të miratojnë ligje dhe të mbrojnë interesin e qytetarit - votuesit, marrin paga të majme, mëditje dhe rrallë herë e përfundojnë seancën me kuorum që paraqet shkelje të rëndë të etikës profesionale dhe zotimit ndaj qytetarit. Në Kuvendin e Kosovës kemi një situatë absurde; Lista Serbe bojkoton punën e Qeverisë së Kosovës shkaku se nuk i realizohen kërkesat shantazhuese dhe kjo, nga shumica e subjekteve politike si dhe deputetëve kalon në heshtje kurse, në anën tjetër, pa asnjë të drejtë ligjore nuk i lejohet pjesëmarrja një ministri

të kabinetit qeveritar në seancën e Kuvendit në kuadër të përgjegjësisë që i ka si ministër. Deputeti apo deputetët nuk kanë të drejtë të lejojnë apo, edhe më keq të zbatojnë standarde të dyfishta për faktin se Kuvendi e mbikëqyr punën e Qeverisë, duke mos bërë dallime midis subjekteve politike. Pozita dhe opozita nuk po gjejnë gjuhë të përbashkët edhe për çështje që e përcaktojnë dhe përkufizojnë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran e që brutalisht po kundërshtohet nga Serbia, Lista Serbe sikur që shumë po dëmtohet nga mungesa e unitetit midis pozitës dhe opozitës. Në rrethanat ekzistuese, pavarësisht se sa vota do të ketë

pozita (edhe pas zgjedhjeve të parakohshme eventuale), nuk mund të arrihet një marrëveshje përfundimtare me Serbinë pa një konsensus politik dhe kombëtar andaj është i papranueshëm bojkoti i opozitës për këtë çështje. Edhe për postin e presidentit po thyhen shtizat duke e kushtëzuar këtë post me shkuarje në zgjedhje të parakohshme e që aspak nuk siguron se presidenti do të zgjidhet pas këtyre zgjedhjeve, nëse mungon një konsensus politik dhe nëse si kriter përdoret karshillëku politik, nga pozita e të fortit. Po ka probleme edhe për miratimin e buxhetit për vitin 2021 e që është jashtë çdo logjike të shëndoshë, aq në parë, që, për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 kemi një gjendje të jashtëzakonshme, ku mund të diskutohet për një buxhet të mbijetesës e jo një buxhet zhvillimor. Për KMDLNj-në, kërkesa e opozitës për zgjedhje të parakohshme apo të jashtëzakonshme është e ligjshme dhe demokratike mirëpo, paraprakisht duhet të përmbushen disa kushte siç është miratimi i Buxhetit të Kosovës (pa buxhet nuk mund

të organizohen zgjedhjet), eventualisht të arrihet marrëveshja për një president konsensual dhe përfundimisht të caktohet data e zgjedhjeve, gjithashtu me marrëveshje të të gjitha subjekteve politike. Deri atëherë duhet të manifestojnë një kulturë demokratike sikur që opozita duhet ta luaj një rol konstruktiv dhe, deri në ditën e fundit të qeverisjes aktuale kjo qeveri duhet të pranohet si qeveri legjitime sepse është e tillë dhe është votuar në Kuvendin e Kosovës. Kosova është në probleme të mëdha, do të përballet me probleme edhe më të mëdha, sidomos pas përfundimit të pandemisë dhe vazhdimin të bisedimeve me Serbinë. Mungesa e bashkëpunimit pozitë - opozitë edhe për çështje vitale për shtetin, pandemia dhe humbja e madhe e vendeve të punës, varfërimi galopant i qytetarëve të Kosovës, pasiguria ekonomike, sociale, politike dhe e sigurisë e rëndojnë edhe më shumë funksionimin normal të shtetit andaj, nëse duam të kemi shtet, duhet të sillim si ndërtues të shtetit, politikanë dhe qytetarë, çdonjëri në saje të përgjegjësisë që i ka!

Qeveria miraton Strategjinë Kundër Korrupsionit për dy vjetët e ardhshëm

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit 2021-2023. Në mbledhjen e qeverisë u theksua se Strategjia Kundër Korrupsionit 2021-2023 dhe plani i saj i veprimit janë përgatitur me një qasje gjithëpërfshirëse që ta trajtojë korrupsionin si një agjendë horizontale, ku të gjitha institucionet relevante ndërveprojnë për zbatimin e saj



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

Prishtinë, 21 dhjetor - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së hënës ka miratuar Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit 2021-2023. Me vendimin për miratimin e kësaj strategjie obligohen të gjitha institucionet e përmendura në Strategjinë Kundër Korrupsionit dhe planin e veprimit 2021-2023 për zbatimin e saj. Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh edhe nga legjislacioni në fuqi, respektivisht nga korniza ligjore që mbulon deklarinimin e pasurisë, konfliktin e interesit, mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe është një obligim që rrjedh nga anëtarësimi i Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit. Në mbledhjen e qeverisë u theksua se Strategjia Kundër Korrupsionit 2021-2023 dhe plani i saj i veprimit janë përgatitur me një qasje gjithëpërfshirëse që ta trajtojë korrupsionin si një agjendë horizontale, ku të gjitha institucionet relevante ndërveprojnë për zbatimin e saj. Kjo strategji përmban veprime prioritare, kryesisht nën përgjegjësinë e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për fuqizimin e mekanizmave përkatës për luftimin e korrupsionit, për rritjen e transparencës së veprimeve të institucioneve publike, integritetin e zyrtarëve publikë dhe transparencën në procedurat e rekrutimit të tyre, përmirësimin e kornizës ligjore kundër korrupsionit etj. Sidoqoftë, Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandohet që

në kuadër të përgjegjësisë të saj, ta plotësojë dhe përforcojë vazhdimisht strategjinë dhe planin e veprimit, në mënyrë që këto t'u përgjigjen sfidave dhe pengesave të identifikuar për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Duhet theksuar se, meqenëse parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është një fushë shumë e gjerë dhe është prioritet i kësaj qeverie, kjo strategji do të plotësohet, përforcohet edhe me dokumentet e tjera strategjike, konkretisht me Strategjinë e Sigurisë së Kosovës dhe Strategjinë e Drejtësisë, të cilat shumë shpejt do të sillen për miratim në qeveri.

Në këtë mbledhje të kabinetit qeveritar ka marrë miratimin Projektligji për ratifikimin e amendamentimit të marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10. Ky amendament i marrëveshjes vjen si rezultat i kërkesës për zgjatjen e afatit të kredisë deri në vitin 2020 sepse, sipas marrëveshjes bazë, data e fundit e disponueshmërisë së mjeteve të kredisë ka qenë 15 dhjetori i vitit 2018.

Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi në kontekstin e aderimit në Bashkimin Evropian gjithashtu ka marrë miratimin e kabinetit qeveritar. Aprovimi i këtij projektligji do t'i shërbejë Qeverisë së Republikës së Kosovës për përafrimin dhe realizimin e objektivave për integrim në Bashkimin Evropian,

duke zhvilluar bashkëpunimin e ndërsjellë midis dyja vendeve. Të dy vendet do të shtojnë dialogun për rritjen e bashkëpunimit në kontekstin e integritetit dhe aderimit si dhe në afirmimin e vlerave evropiane. Marrëveshja synon ta rrisë stabilitetin në rajon si dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal. Fokus i veçantë i marrëveshjes do të ketë bashkëpunimi ekonomik dhe tregtar, lëvizja e lirë e njerëzve dhe e kapitalit, bashkëpunimi në fushën e sundimit të ligjit dhe harmonizimi i legjislacioneve me Acquis të BE-së.

Miratohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zonat ekonomike

Në këtë mbledhje të qeverisë është miratuar edhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zonat ekonomike. Projektligji ka për qëllim qartësimin e procedurave për themelimin, administrimin dhe menaxhimin e zonave ekonomike, vendndodhjen e zonave ekonomike, mënyrën e shfrytëzimit dhe promovimit të zonave ekonomike. Krijimi dhe zhvillimi i zonave ekonomike mundësohet përmes investimeve të reja, aktiviteteve industriale, lehtësimit të hyrjes së

mallrave dhe kapitalit, përmes aplikimit të teknologjive të avancuara, krijimit të vendeve të reja të punës si dhe nxitjes së investimeve të huaja dhe shkëmbimeve tregtare.

Po ashtu, kabinetit qeveritar ka miratuar edhe Projektligjin për Filarmoninë e Kosovës, Operën e Kosovës dhe Baletin Kombëtar të Kosovës. Projektligji rregullon organizimin e veprimtarisë dhe funksionimin e institucioneve të Filarmonisë së Kosovës, Operës së Kosovës dhe Baletit Kombëtar të Kosovës, të cilat ushtrojnë veprimtari kulturore-artistike me interes të veçantë për Kosovën.

Qeveria në këtë mbledhje ka shqyrtuar dhe miratuar vendimin për kriteret e mbështetjes së Ndërmarrjeve Publike në zbatim të masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës në përputhje me Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Është aprovuar edhe koncept-dokumenti për ndryshimet klimatike. Koncept-dokumenti ka identifikuar problemet dhe sfidat që lidhen me përmirësimin e legjislacionit primar dhe sekondar ekzistues që rregullon çështjet nga fusha e ndryshimeve klimatike përmes transpozimit të legjislacionit të BE-së, duke e pasur në konsideratë angazhimin e Republikës së Kosovës në këtë drejtim.

Qeveria e Republikës së Kosovës

ka miratuar dy vendime për t'i kërkuar autorizim presidentit të Republikës së Kosovës për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për financimin dhe drejtimin e projektit Heras+/Arsimi i Lartë, Hulumtim dhe Shkenca Aplikative në Kosovë midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim - ADA.

Me vendimin tjetër i kërkohet presidentit të Republikës së Kosovës që ta autorizojë nënshkrimin e Marrëveshjes për Amendamentin 02 të marrëveshjes dypalëshe në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Luksemburgut për projektin e bashkëpunimit për zhvillim "Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë".

Gjithashtu, kanë marrë miratimin e qeverisë edhe dy nisma për lidhje të marrëveshjeve ndërkombëtare: Marrëveshja ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për kalimet e përbashkëta kufitare në "Hani i Elezit-Billacë" dhe "Gllloboqicë-Jazhincë" dhe marrëveshja për bashkëpunim në turizëm në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Reshitaj takon Shoqatën e Prindërve të Ndarë, premtion mbështetje të rezervë



PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Deputetja e Kuvendit nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Albena Reshitaj, ka pritur të hënën në takim përfaqësueset e Shoqatës të Prindërve të Ndarë (Single Parent Association APS). Reshitaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se kjo është e vetmja shoqatë përfaqësuese që për qëllim ka mbështetjen dhe

fuqizimin e prindërve të vetëm në Kosovë. "Shoqata e Prindërve të Ndarë është e vetmja shoqatë përfaqësuese që ka për qëllim mbështetjen dhe fuqizimin e prindërve të vetëm në Kosovë duke kontribuar për një jetë më të mirë për ta dhe për fëmijët e tyre. Kjo shoqatë ka identifikuar mbi 150 nëna të të gjitha komuniteteve në komunat e Kosovës, por ka edhe shumë të tjera të

paidentifikuar dhe që kanë nevojë për përkrahje institucionale", ka thënë Reshitaj. Ajo i ka siguruar kësaj shoqate mbështetje në misionin e tyre. "U sigurova mbështetje të rezervë në misionin e tyre për promovimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e nënave vetëushqyese, për qasje në shërbime, të drejtën pronësore dhe fuqizimin e tyre ekonomik", është shprehur Reshitaj.

Ekonomia mbijetoi për të mos shkuar në kolaps



PRISHTINË, 20 DHJETOR - Jahir Morina, pronar i kompanisë "Princesha" në Prishtinë, ka mbajtur gjallë kompaninë gjatë nëntë muajve të pandemisë falë rezervave financiare. Morina thotë se kompania e tij, e cila biznesin e ka të shtrirë në sektorin e ndërtimit dhe të gastronomisë, nuk ka arritur të krijojë të hyra financiare, por ka pasur vetëm shpenzime. "Kompania 'Princesha' në fushën e ndërtimit, për të mos e ndërprerë aktivitetin e saj, ka investuar mbi 4 milion euro, ndërsa në gastronomi ka investuar 500 mijë euro për t'i

paguar të gjitha obligimet që kanë qenë në vitin 2020", thotë ai.

Sektori i ndërtimit, sipas një hulumtimi të bërë nga Instituti GAP, konsiderohet si një nga sektorët më të prekur nga pandemia Covid-19.

Morina tregon se, krahasuar me vitin e kaluar, shitja e banesave ka shënuar një rënie për 80 për qind. Morina thotë se deri tani ka mbijetuar falë rezervave financiare që i ka pasur si biznes, por të cilat tashmë janë shpenzuar dhe nëse nuk do të ketë ndihmë nga shteti, problemet do të paraqiten në

vitin 2021. "Do të përballemi me një kolaps ekonomik që shumë shpejt do të reflektohet në mbarë ekonominë", thotë ai.

Masat kundër përhapjes së pandemisë kanë ndikuar në masë të madhe në ekonominë e Kosovës duke krijuar humbje deri më tani në 1 miliard euro, sipas të dhënave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) dhe shoqatave ekonomike.

Këto humbje nuk arritën të mbulohej nga ndihma që shteti ndau për ekonominë.

Por, kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, thotë

se ekonomia e brishtë e Kosovës, me një rritje ekonomike jo më shumë se 4 për qind ndër vite, brenda nëntë muajve të pandemisë me Covid-19, arriti të mbijetojë për të mos u futur në kolaps. "Ekonomia e vendit mund të themi se ka shpëtuar nga kolapsi, por jo që shteti e ka ndihmuar shumë, por qytetarët dhe bizneset kanë pasur rezerva dhe i kanë përdorur ato mjete në këtë kohë", thotë Shahini.

Bizneset dhe qytetarët në Kosovë, në bazë të të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), kanë depozita miliarda euro në dhjetë bankat

komerciale në Kosovë.

Vlera e depozitave të klientëve, sipas këtyre të dhënave të BQK-së, ka arritur në mbi 4 miliardë. Prej tyre më shumë se 2 miliardë euro janë të ekonomive familjare dhe të tjerat janë të korporatave jofinanciare dhe financiare. Megjithatë, me këtë vlerësim nuk pajtohen përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, të cilët nga fondet për t'i ndihmuar bizneset e prekura nga masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19 deri më tani i ka ndihmuar bizneset me rreth 150 milionë euro. Zëvendësministri i Financave,

Reçica: Sektori i gastronomisë duhet mbështetur pazezervë

Prishtinë, 21 dhjetor (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e Shoqatës së Gastronomëve

të Kosovës, me të cilët ka diskutuar për situatën e vështirë në të cilën ndodhet sektori i gastronomisë, që ka pësuar goditjen më të madhe si pasojë e

pandemisë ku, fatkeqësisht, edhe një numër i madh i punëtorëve kanë humbur vendet e tyre të punës. Përfaqësuesve të Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës,

ministri Reçica u ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të MPMS-së për ta mbështetur pazezervë sektorin e gastronomisë, brenda mundësive ligjore.



Agim Krasniqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se për ta ndihmuar ekonominë e Kosovës që të mos futet në krizë të thellë nga pandemia, projektuan në atë mënyrë që biznesi të ndihmohet nga shteti, por edhe nga vetë biznesi. "Nga fillimi kur ka nisur pandemia, është thënë që humbjet do të mundohemi t'i mbulojmë bashkërisht. Ne e kemi ditur kapacitetin e buxhetit të shtetit dhe kemi thënë që do t'i mbulojmë humbjet për aq sa ka hapësirë

fiskale dhe buxhetore. Kjo hapësirë është shfrytëzuar për aq sa ka lejuar Ligji për buxhetin", thotë Krasniqi. Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike, i miratuar më 4 dhjetor, parasheh 600 milionë euro, nga cili fond do të përfitojnë bizneset dhe qytetarët. Ekonomia e Kosovës, thotë Krasniqi, këtë fazë po e kalon me mjaft sfida, mjaft probleme, mirëpo ka arritur të mbijetojë dhe të mos futet në kolaps.

Trusti nis ekzekutimin e mjeteve të 10-përqindëshit

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës ka njoftuar se ka filluar ekzekutimi i pagesave për 10-përqindëshin e mjeteve të Trustit. "Të nderuar kontribuues, pas përpjekjeve maksimale nga stafi i Trustit, që pagesat të kryhen sa më shpejt, ju bëjmë të ditur se sot, gjatë ditës, fillon ekzekutimi i pagesave për aplikimet e realizuara më datë 11 dhjetor 2020. Pas dërgimit të mjeteve në banka, presim që pagesat të dalin në llogari të përfituesve brenda

24 orëve. Për informim, më 11 dhjetor kanë aplikuar 219 729 kontribuues dhe për ta do të shpaguhet rreth 112.2 milionë euro", ka njoftuar Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, duke bërë me dije se ekzekutimi i këtyre mjeteve do të vazhdojë edhe në ditët e ardhshme. "Ndërsa më 22 dhjetor do të ekzekutohen pagesat për aplikimet e realizuara prej 12 deri 17 dhjetor 2020. Edhe ato presim të dalin në llogari brenda 24 orëve të tjera. Këtu përfitues janë 137 543 kontribuues me rreth 58.3 milionë euro.

Shuma totale e aplikimeve në 7-ditëshin e parë, prej 170.5 milionë eurosh, është e përbërë nga: kontributet në masën 137.7 milionë euro dhe fitimet nga investimet në vlerë 32.8 milionë euro. Vëmendje: Lusim të gjithë kontribuuesit që t'u përmbahen udhëzimeve të dhëna nga bankat, që për tërheqjen e mjeteve t'i përdorin kartelat bankare ose pagesat përmes e-banking dhe të shmangin vizitat fizike nëpër banka", ka njoftuar Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Pako mbi 1 miliard euro për t'i shpëtuar bizneset

Ai thotë se nëse dëshirohet një ekonomi stabile, duhet të fokusohen në pako të tjera të rimëkëmbjes ekonomike dhe mjetet buxhetore të parapara në investime kapitale, të orientohen në sektorin privat. "Kompanitë që arritën të mbijetojnë në vitin e ardhshëm mund të falimentojnë për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Prandaj qeveria duhet të angazhohet që pakaja e radhës që do t'i ndihmonte bizneset, të jetë më e madhe, së paku të kalojë një miliard euro", thotë Bektashi.

Këto mjete, thotë profesori Bektashi, mund të sigurohen

nga të hyrat buxhetore si dhe nga marrja e kredive nga institucionet e ndryshme financiare ndërkombëtare. Kosova për vite me radhë ka pasur një rritje ekonomike mesatarisht rreth 4 për qind, e cila ka qenë e pamjaftueshme për ta zbutur papunësinë dhe problemet ekonomike dhe sociale.

Ndërkaq, për këtë vit guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, pati deklaruar se si rezultat i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19, ekonomia e Kosovës në vitin 2020 do të shënojë rënie deri në 7.2 për qind.



Bajrami priti në takim ambasadorin e Japonisë, flasin për bashkëpunimin e dy vendeve



PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka pritur të hënën në takim të ngarkuarin me punë në

Ambasadën e Japonisë në Kosovë, Mitsunori Ogasawara. Ministrja Bajrami dhe ambasadori Ogasawara bashkëbiseduan

për situatën ekonomike, menaxhimin e pandemisë si dhe për tema të interesit të përbashkët të të dyja vendeve. Pikë e veçantë e

diskutimit ishte organizimi i seminarit të biznesit Kosovë - Japoni i cili do të mbahet me datë 14 janar 2021 në formë virtuale. Qëllimi i këtij

seminari është dialogu me palën japoneze me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve tona.

Plagoset një 58 vjeçe, sekuestrohen dy armë zjarri në Podujevë

PODUJEVË, 21 DHJETOR - Të dielën rreth orës 23:50 është pranuar një informatë për një rast të plagosjes me armë zjarri në rrugën "Hasan Prishtina" në Podujevë. Policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe, mbështetur në të dhënat e para të ekzaminimit dhe atyre të intervistimit, janë ngritur dyshimet se aksidentalisht në shtëpinë e saj me armë zjarri

është plagosur një 58-vjeçare, shtetase e Republikës së Kosovës, e cila ka marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor në QKUK. Ndërkohë kanë vazhduar veprimet operativo-policore, janë sekuestruar dy armë zjarri, një revole e tipit "Glock", një revolver i tipit "Zastava" si dhe trembëdhjetë copë fishekë. Lidhur me rastin policia ka

shoqëruar në stacionin policor dy persona të dyshuar.

Hetuesit policor kanë nisur një hetim për sqarimin e të gjitha rrethanave që karakterizojnë rastin përderisa të dyshuarit janë proceduar më tutje për lëndim të rëndë trupor si dhe mbajtje në pronësi dhe posedim të paautorizuar të armëve.



Lladrovci vlerëson me mirënjohje komandanten e policisë në Drenas

DRENAS, 21 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, bashkë me stafin e vet dhe drejtoreshat e shkollave, ka pritur në takim për fundvit komandanten e Stacionit Policor në Drenas, Feime Bajrami.

Kryetari Lladrovci në këtë takim ka vlerësuar punën dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me Stacionin Policor në Drenas, duke i përgëzuar për punën gjatë vitit 2020 në funksion të ruajtjes së sigurisë dhe shëndetit publik.

Lladrovci për komandanten Bajrami ka ndarë mirënjohje për profesionalizimin dhe kontributin e dhënë gjatë kohës së pandemisë, për ruajtjen e shëndetit dhe rendin publik në Komunën e Drenasit. Po ashtu, Lladrovci i ka dhuruar medaljonin e punuar nga Qendra e Promovimit të



Drejtave të Grave, Dega në Drenas.

Ndërsa komandantja e policisë, Feime Bajrami, është shprehur e kënaqur me bashkëpunimin dhe përkrahjen nga kryetari Lladrovci që të ruhen shëndeti dhe siguria e

përgjithshme e qytetarëve. Kryetari Lladrovci dhe komandantja Bajrami janë zotuar që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm në zbatim të ligjit dhe Kushtetutës së vendit, për garantimin e sigurisë dhe shërbimeve profesionale.

Parkingu i Komunës së Malishevës do të jetë në shërbim të mërgimtarëve

MALISHEVË, 21 DHJETOR (ER) - Në emër të kryetarit të Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, nënkryetari Hajdin Berisha ka urdhëruar Drejtorinë e Administratës, se duke filluar nga 21 dhjetor 2020 e deri më 21 janar 2021 parkingu në oborrin e kësaj komune do të jetë në shërbim vetëm të mërgimtarëve.

Komuna e Malishevës ka njoftuar se me këtë vendim ndalohet parkimi i veturave nga zyrtarët komunalë apo veturat e tjera private. "Në urdhëresën administrative,

01/1379 të datës 21/12/2020, urdhërohet Drejtoria e Administratës, që përmes shërbimit të sigurimit ta ndalojë parkimin e automjeteve private në oborrin e komunës për të gjithë punëtorët e administratës së komunës dhe të gjitha veturat e tjera private, nga ora 08:00-16:00, për shkak të liritimit të hapësirës së mjaftueshme për parkim gjatë marrjes së shërbimeve komunale, për të gjithë mërgimtarët e Komunës së Malishevës dhe më gjerë", ka njoftuar Komuna e Malishevës.



Shkollat e Mitrovicës përfunduan me sukses gjysëmvetorin e parë shkollor

MITROVICË, 21 DHJETOR (ER) - Drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i Bordit dhe drejtorive komunale. Fillimisht, drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar ekzekutivin për fluksin e madh të punëve në këtë drejtori "meqë jemi në përfundim të këtij viti dhe përpjekjet që zotimet dhe pagesat të realizohen brenda afatit të caktuar kohor".

Ndërsa drejtori i Arsimit, Ismet Ferizi, ka informuar drejtorët komunalë lidhur me përfundimin e gjysëmvetorit të

parë të vitit shkollor 2020/21, duke potencuar se gjatë pandemisë situata në institucionet edukativo-arsimore është menaxhuar mjaft mirë. Me këtë rast, ai ka theksuar se ky gjysmëvetor ka përfunduar më 18 dhjetor 2020, një javë para kohës së planifikuar me kalanderin shkollor sipas vendimit të qeverisë, por që nga Ministria e Arsimit në bashkëpunim me DKA-të do të bëhet një plan për kompensim të kësaj jave. "Nga 33 institucione edukative-arsimore (1 çerdhe, 27 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme) që i ka Komuna e Mitrovicës, 20 prej tyre procesin mësimor e kanë realizuar me skenarin A (me prani të plotë fizike), ndërsa 13 institucione të tjera arsimore




e kanë realizuar skenarin A dhe B (me prani të pjesshme fizike dhe platformës online)", ka thënë Ferizi. Në fund të kësaj mbledhje,

drejtori për Mbrojtje të Mjedisit, Hysni Ahmeti, ka bërë me dije se Komuna e Mitrovicës është radhitur e para në nivel të Kosovës me gjithsej 80 pikë për

performancën më të mirë në kuadër të grantit të performancës - mjedisit i pastër, duke u shpërblyer me grant në vlerë prej 235 647 eurosh.

GOZHDA E VARUR NË MUR...



Nga Bedri ISLAMI

Problemet e mëdha që ka para vetes Kosova, sidomos përplasjet e brendshme, që shpeshherë e kanë burimin jashtë saj, gjendja e paqartë e sigurisë dhe enigma e të ardhmes, jo vetëm të afërt, por edhe përtej saj, duket sikur kanë lënë në harresë një ndër çështjet më të rëndësishme të saj, Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, që tashmë po shtrohet me zë disi të ulët, por që do të mund të ishte ndër më rënduesit e saj.

Edhe tani, politika e shkallës së lartë serbe, ndërsa përbetohet se nuk do ta njohë kurrë Kosovën si shtet të pavarur, vëmendjen e ka pikërisht te kjo krijesë, e cila e bën të pranishme në Kosovë edhe pa qenë ushtarakisht aty, e bën të ndjeshme, në heshtjen e dukshme të saj; krijon tamponin për të depërtuar edhe më lirisht se deri tani, ndërkohë krijon hapësirën e ardhshme të destabilizimit.

Është i njohur fakti se të gjitha qeveritë që kanë kaluar nëpër Kosovë, pavarësisht kush ka qeverisur, kanë qenë të rrepta me vendësit e kahershëm, ndërsa kanë qenë tej liberalë me pakicën serbe, e cila ka bërë çfarë ka dashur, është sjell si shtet brenda shtetit, si qendër e trafikut, depërtimit të kontrabandës, por edhe të krimin.

Asnjëra qeveri, duke hapur dyert, nuk e ka menduar se kjo qasje serbe, në dukje e parrezikshme, është si ajo gozhda e Nastradinit, e varur në mur, por që përditë ngulet më thellë.

Megjithëse ka një vendim refuzues të Gjykatës Kushtetuese ndaj projekteve dhe vendimeve të qeverive të Kosovës, prania e këtij plani është në tryezat e Perëndimit, çka u shtrua edhe në ditët e fundit si një domosdoshmëri për të ecur "përpara" në marrëdhëniet në mes të Serbisë dhe Kosovës.

Çfarë do të ndodhë dhe çfarë po përgatitet në skutat e diplomacisë serbe?

Historikisht, sa herë që shteti serb ka dashur të bëjë një lëvizje të re politike, shoqëruar me dhunë dhe përgjakje, çdo gjë ka nisur nga fjalët e përhapura, fillimisht nga një pjesë e klerit të lidhur fort me pushtetin, pastaj nga njerëz të lidhur drejtpërsëdrejti me qeverinë serbe, edhe është demantuar fillimisht prej saj,

ndërkohë që ka përgatitur skenarin e një "incidenti" apo zgjidhje të mundshme.

Kjo po ndodh edhe tani në Kosovë.

Ka disa ditë që përfaqësues të lartë të klerit ortodoks serb, pas tyre, njerëz të politikës, po sjellin dëshmi se nëse nuk do të ketë një ditë të përcaktuar qartë, kur duhet të përmbillet, sipas tyre, koncesioni politik i Asociacionit, krijimit të një strukture të veçantë për komunat me shumicë serbe, atëherë do të ketë trazira, do të shpallet autonomia e serbëve në Kosovë, do të ngrihen strukturat e saj dhe e gjithë kjo do të ketë si paraprirje dhune të dyanshme: nga protestuesit serbë dhe, përballë tyre, Policia e Kosovës. Zgjedhjet e fundit komunale në Mitrovicën e Veriut, që kishin një rezultat të pritshëm për shkak të shpërnguljes me dhunë të banorëve shqiptarë nga shtëpitë dhe pronat e tyre, kanë forcur megollamaninë serbe dhe mllëfin për t'i përmbysur gjërat, sa më shpejt të jetë e mundur, e këtë kohë politike, kur partitë ende nuk e dinë se çfarë kahesh do të marrin zhvillimet, ata e shohin si një dhuratë që ua bënë miopia politike shqiptare.

Mediat që i bëjnë jehonë këtij versioni, duke sjellë "të dhëna" shtesë, kanë bërë thirrje që banorët e veriut të Kosovës, sidomos në Mitrovicën e Veriut, por edhe nga komuna të tjera, të mos largohen nga vendi i tyre, por fuqimisht të jenë të gatshëm për ta bërë përballjen e tyre e forcat e ndërhyrjes së policisë kosovare, e cila, si vihet në dukje jorastësisht, ka edhe mbështetjen e strukturave të posaçme ndërkombëtare.

Krijimi i një qendre autonome për serbët në Kosovë ka nisur të lulëzojë si mendim pas ngjarjeve të marsit të vitit 2004 kur, pas dhunës së ushtruar ndaj fëmijëve shqiptarë që, të ndjekur nga huliganët serbë, u

mbytën në lumin e Ibrit, kishte një revoltë të pallogaritur shqiptare dhe përplasje të ndjeshme edhe me forcat ndërkombëtare.

Edhe atëherë ishte thënë në mjaft media serbe, por edhe nga peshkopë serbë, se muaji mars do të ishte një muaj përlëshjesh dhe se "banditët" shqiptarë po përgatiten t'i djegin kishat dhe manastiret serbe, përgjithësisht vendet që ata i quajnë të shenjta dhe të paprekshme. Shumicën e të cilave e dogjën vetë.

Në vitin 2004, kur zemërimi nga zvarritjet ndërkombëtare për statusin e një shteti të ri po shkonte përtej limitit të pritjes, skanimit serb përlogariti gjithçka dhe, duke përfituar nga veprimet e dënueshme të rebelimit shqiptar, i vunë flakën, më shumë vetë ata se të tjerët, disa prej ndërtesave fetare, duke hedhur akuzën mbi revoltën shqiptare.

Tani, sipas një skenari që kundërshtohet nga një pjesë e udhëheqjes serbe dhe mbështetjet nga pjesa tjetër, jo vetëm më radikale, por edhe me duart e zëna herë pas here në skenën politike të Kosovës, pakica serbe në Kosovë, sipas modelit boshnjak, po përgatitet ta shpallë autonominë, sidomos autonominë e veriut të serbëve të Kosovës, si një fillesë për të krijuar një strukturë të veçantë, dominuese dhe radikale.

Që në vitin 2004 shteti serb ka ngritur strukturat e veçanta, më të specializuara për Kosovën. Në të janë përfshirë akademikë të njohur, politologë, klerikë nacionalistë të rrymës së ashpër, ushtarakë që kanë pasur të kaluar në Kosovë dhe, për fat të keq, edhe shqiptarë të serbizuar.

Përmes këtij mekanizmi të fuqishëm tashmë janë bërë të gjitha detajet e posaçme për zhbërjen e shtetit të Kosovës, afrimin e një lëvizje nacionaliste serbe në drejtimin e pakicës serbe në Kosovë,

depërtimin financiar dhe ekonomik përmes firmave të tyre dhe lidhje të dyanshme, rrëzimin e miteve dhe të vërtetave historike, deri në rrënimin e mitit dhe të vërtetës së një figure madhore kombëtare si ajo e Adem Jasharit apo të Adem Demaçit, çka dha frutet e saj në ditëlargimin nga jeta të Demaçit, deri në lëvizjet politike, sociale dhe nacionale të serbëve në Kosovë.

Pjesë e këtyre studimeve është edhe lëvizja e tashme, e bërë në pikun e bisedimeve Kosovë - Serbi, kur shumë gjëra janë ende nën mjegullën e enigmës dhe kur spekulimet janë më të shumta se të vërtetat e thjeshta.

Është periudha kur secila palë në këto bisedime kërkon ta tërheqë litarin nga ana e vet, të përfitojë deri në momentin e fundit dhe, nëse pala serbe po i zhvillon të gjitha bisedimet mbi bazën e një platforme të ngritur mbi mendimin akademik, shqiptarët, si palë fituese e një lufte dhe bashkëfenduese e afërt e mendimit politik euroatlantik, është ende e ngritur mbi folklorizmin, inatet dhe ndasitë, të cilat, nëse do të bjerë qoftë edhe një hektar tokë, si ndodhi në demarkacionin me shtetin malazez, nuk do të ketë fitues dhe as të mundur. Të mundur do të jemi të gjithë.

Pikërisht në këtë kohë, jorastësisht, struktura të veçanta serbe që nga njerëzit e shërbimit të saj sekret e deri te peshkopët radikalë ngrehin çështjen e autonomisë për serbët, sidomos në veriun e Kosovës.

Edhe mund ta provojnë në një ditë jo të largët, provat i kanë dhënë disa herë që janë të aftë të ngrehin pluhur edhe mbi tryezën e bisedimeve, megjithëse këtë herë mund të ketë edhe skena të ashpra dhune.

Dërgimi në Gjykatën Speciale

në Hagë, në fakt pjesë e Kushtetutës së Kosovës, i një pjese të trupës drejtuese të UÇK-së, sipas aktakuzës që vetë prokuroria serbe në shumicën dërrmuese e përgatiti, ka forcur pjesërisht pozitën e politikës serbe në bisedimet e ardhshme, por edhe këmbënguljen e saj për ta ngulur këtë "gozhdë" në trupin e Kosovës. Përfaqësuesi i BE-së për Kosovën duket shumë më afër llogoreve serbe sesa pozicionit shqiptar.

Përballë tyre, politikës serbe dhe mbështetësve të saj të njohur tashmë, do të jetë shteti i Kosovës dhe liderët e saj që këtë herë janë të ndarë pikë e pesë, duke mos ditur nëse do të ketë një president të ri apo zgjedhje të reja politike.


Asnjëri prej tyre, kushdo qoftë në qeverisje, nuk e ka të drejtën që të lejojë, qoftë edhe në formë mashtrimi apo provokimi, një strukturë që i bie ndesh Kushtetutës së Kosovës.

Shteti dhe Qeveria e Kosovës si duket ende nuk i kanë marrë seriozisht paralajmërimet për një lëvizje radikale serbe dhe nuk duket se janë përgatitur për përballimin e një ngjarje të tillë, të hidhur dhe që nuk do të mund të kalojë pa pasoja. Serbët, nëse e kanë vërtet jo vetëm të menduar, por edhe të planifikuar një lëvizje të tillë, qoftë autonomiste, qoftë diçka tjetër, kanë bërë llogari të mbrapshta dhe nuk i kanë menduar saktësisht të gjitha pasojat.

Nuk mund të ketë autonomi, as politike, as territoriale, as financiare dhe as shtetërore për një pakicë serbe që, e ndarë në zona të ndryshme banimi, me një pjesëmarrje më pak se 5 për qind të popullsisë, që nga shteti i Kosovës ka marrë mbi 150 milionë euro donacione, e që është përsëri synuese për shkatërrimin e vlerave të krijuara kur, për më tepër, as disa kilometra larg tyre, në një konfiguracion kompakt, në Kosovën Lindore, jeton një popullsi hegjemone shqiptare, së cilës nuk i lejohet as flamuri i tyre kombëtar dhe po detyrohen përdhunshëm të largohen nga vendlindja.

Provokimi serb mund të jetë i planifikuar jo shumë larg Kosovës, por e vërteta do të jetë aty. Do të jetë edhe një provë qëndrueshmërie e strukturave drejtuese të Kosovës si dhe prova e fundit në bisedimet e vështira për të ardhmen mes dy vendeve. Kur një shtet, edhe sot e kësaj dite, e trajton kufirin e Kosovës me shtetet fqinje, njëjtë si në ditët e Millosheviqit, ai nuk ka mësuar asgjë, por edhe prej tij duhet pritur çdo gjë. E keqja nuk është një ves që harrohet. Sidomos nga serbët nacionalistë.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Me meritë jemi kampionë vjeshtorë

Sulmuesi Kastriot Rexha ka thënë se Drita e Gjilanit me meritë e ka përfunduar sezonin vjeshtor në pozitën e parë në Superligë. “Jemi të kënaqur me suksesin e arritur. Kemi luajtur me një orar të ngjeshur dhe në fund na është shpëguar mundi. Atmosfera e mirë në klub, angazhimi i futbollistëve dhe puna e shtabit teknik dhe drejtuesve të klubit kanë qenë në ndërlidhje me suksesin e arritur me meritë, por mund të them se edhe Ballkani po të ishte në vendin e parë do të ishte normale”, ka thënë Rexha



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Të dielën edhe zyrtarisht përfundoi sezoni vjeshtor në Superligën e Kosovës në futboll, kurse skuadra e Dritës është shpallur kampione vjeshtore. Sulmuesi Kastriot Rexha ka thënë të hënën për “Epokën e re” se skuadra nga Gjilani me meritë e përfundoi sezonin vjeshtor në vendin e parë pse një gjë të tillë e ka merituar edhe Ballkani që ka shfaqur lojërë të mira. “Jemi të kënaqur me suksesin e arritur. Kemi luajtur me një orar të ngjeshur dhe në fund na është shpëguar mundi. Atmosfera e mirë në klub, angazhimi i futbollistëve dhe puna e shtabit teknik dhe drejtuesve të klubit kanë qenë në ndërlidhje me suksesin e arritur me meritë, por mund të them se edhe Ballkani po të ishte në vendin e parë do të ishte normale”, ka thënë Rexha. “Ne morëm rezultate

pozitive në vazhdimësi, ndërsa Ballkani pati një krizë të rezultateve. Këtë e shfrytëzuam me marrjen e pozitës së parë”, ka shtuar Rexha.

Sulmuesi shtatlartë e komentoj edhe barazimin në ndeshjen e fundit kundër Prishtinës (1-1) që u zhvillua të dielën në stadiumin “Fadil Vokrri”. Ai tha se Drita mori një pikë nga ndeshja, por nuk u paraqit ashtu siç duhet. “Kemi pasur mungesa e lëndime në ndeshjen ndaj Prishtinës, prandaj nuk ka qenë një prej paraqitjeve tona të mira. Pavarësisht se kishim ardhur për fitore, në fund jemi të kënaqur edhe me barazimin e arritur”, ka deklaruar ai.

Nëntë pikë është dallimi në mes tri skuadrave të para në Superligë, Dritës, Ballkanit dhe Prishtinës, por Rexha e sheh në garën për titull edhe skuadrën e Gjilanit që ka dymbëdhjetë pikë më pak se skuadra e parë. “Përveç nesh, Ballkanit dhe Prishtinës, nuk bën të

mos e përfshijmë në garën për titull edhe Gjilanin. Është fakt se ky klub ka pasur disa kriza, por me ardhjen e trajnerit Bylbyl Sokoli është rikthyer optimizmi për rezultate më pozitive. Dëshmoi edhe ndeshja ndaj Ballkanit. Në pranverë do të ketë ndeshje edhe më të forta dhe gara për titull do të jetë shumë interesante”, ka shtuar Rexha.

Sulmuesi prishtinas në edicionin e kaluar ishte shpallur lojtari i vitit në Superligë, kurse për këtë vit e favorizon bashkëlojtarin, Hamdi Namani. “Futbollisti i vitit duhet të jetë nga klubi ynë dhe një prej më meritoreve për suksesin e arritur është Hamdi Namani, i cili meriton të shpallet më i miri për vitin 2020. Ka edhe futbollistë të tjerë që janë paraqitur mirë gjatë këtij viti”, ka përfunduar Rexha, i cili gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Prishtinën, Feronikelin, Trepçën '89, Besën e Pejës, Hysin, 2 Korrikun dhe Vllazninë e Shkodrës.

SHKURT

Më 11 janar bëhet tërheqja e shortit të Kupës

Komisioni i Garave e ka caktuar terminin e tërheqjes së shortit për fazën e 1/8-s së finales së Kupës së Kosovës. Çiftet e kësaj faze do të mësohen më 11 janar në orën 13:00, teksa ndeshjet e këtij rrethi do të zhvillohen më 10 shkurt. Shorti në këtë raund do të jetë i lirë dhe skuadrat nuk do të ndahen nëpër vazo. Ekipe të kualifikuara: Ferizaj, Ulpiana, 2 Korriku, Dukagjini, A & N, Istogu, Flamurtari, Feronikeli, Llapë, Arbëria, Ballkani, Drenica, Drita, Prishtina, Gjilani dhe Trepça '89.

Kuka, politikanëve shqiptarë: Luftoni sikurse sportistët

Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka thënë se dëshira e tij është që Kosova ta kishte tashmë vaksinën për Covid-19 dhe të fillohej me vaksinim si në disa shtete të tjera. Ai ka thënë se politikanët në Kosovë dhe Shqipëri duhet të luftojnë sikurse sportistët, pasi është e vetmja mënyrë për të arritur fitore. “Nora Gjakova kështu iu kishte gëzuar së artës në Evropianin e Tel Avivit kohë më parë! Ekspresionet e saj janë pasqyra e sakrificës për rezultat dhe prezantim të shtetit. Sot, ditë e hënë, do të doja që Kosova ta kishte vaksinën për Covid-19 si shumë shtete që tashmë e kanë dhe kanë filluar vaksinimin. Dua që shtetet tona Kosovë e Shqipëri të punojnë natë e ditë që mos të mbesim të fundit në këtë çështje. Luftoni më fort, shfrytëzoni çdo rrugë e jo duke pritur mëshirë nga organizata të ndryshme. Pa luftë s'ka fitore. Luftoni ashtu si sportistët tanë”, ka shkruar Kuka.

Isaiah Traylor, MVP i xhiros 9

Rahoveci ka mundur Pejën 86:77 në derbin e xhiros së nëntë në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Isaiah Traylor ishte më i dalluari te Rahoveci me 30 pikë, shtatë kërcime, gjashtë asistime, me një indeks prej 26. Traylor ka qenë një nga basketbollistët më të merituar të Vreshtarëve në këtë edicion, duke e ndihmuar të shënojë shtatë fitore në nëntë ndeshje. Ndërkohë, top-5 shënuesit më të mirë të xhiros së nëntë janë: Sean Hoehn i Bashkimit me 32 pikë, Isaiah Traylor i Rahovecit me 30, Xavier Cannefax i Ponte Prizrenit me 30, Drilon Hajrizi i Pejës me 29 dhe Valon Bunjaku i Golden Eagle Yllit me 26.

Përforcohet KBF Prishtina

KBF KosovaHome Prishtina është përforcuar me basketbollisten amerikane Da'jah Daniel që luan në pozitën e qendrës. Lajmi është konfirmuar nga faja zyrtare e klubit kryeqytetas në “Facebook”. Da'jah Daniel, transferimi më i ri i klubit tonë. Qendra Amerikane vjen nga NCAA ku ishte pjesë e Kolegjit ‘Grand Canyon State University’. Daniel është 1.93 cm dhe luan në pozitën e qendrës. Ai do të jetë një ndihmë e madhe për ekipin tonë”, thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas.

Muriqi komenton në gjuhën serbe me Saviqin

ROMË, 21 DHJETOR - Lazio ka shënuar fitore ndaj Napolit në Serinë A. Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, u rikthye nga lëndimi dhe u inkuadrua në 20 minutat e fundit të

takimit. Pas përfundimit të ndeshjes, Muriqi postoi në rrjetin social "Instagram" një fotografi të ndeshjes dhe shkroi se ishte i lumtur për rikthimin e tij. "Jam shumë i lumtur që jam rikthyer dhe që

kam kontribuar në skuadër. Tri pikë shumë të rëndësishme. Forca shqiponja!", ka shkruar Muriqi në "Instagram". Po në këtë postim të tij ka komentuar bashkëlojtari i tij serb,

Milinković-Saviq. Futbollisti serb ka shkruar "Ajde Srce" apo në gjuhën shqipe "Forca zemër". Në të njëjtën gjuhë ia ka kthyer edhe Muriqi duke i komentuar "Ajmo ooo" apo në shqip "Forcaaa".



Seferi: Për Shqipëri gjithmonë e jap maksimumin

TIRANË, 21 DHJETOR - Taulant Seferi është një nga futbollistët që mezi e pret ndërrimin e viteve sepse beson që në janar do të ndërrojë ekip dhe do të ketë mundësi të luajë rregullisht, duke qenë se te kampionët në fuqi të Zvicrës, Young Boys, nuk bën pjesë në planet e trajnerit dhe nuk ka marrë asnjë minutë këtë sezon. Në një lidhje me emisionin "Zona Gol" në Supersport, sulmuesi nga Tetova bashkëbisedoi me moderatorin Glend Tafaj, ku zbuloi se ka oferta nga disa klube dhe se në janar do të largohet nga Young Boys. "Duhej të largohesha që këtë verë, por merkatoja u mbyll shpejt për shkak të koronavirusit dhe nuk arrita të gjej një skuadër tjetër. Te Young Boys nuk kam luajtur fare, por jemi në bisedime me 2-3 skuadra të ndryshme dhe është edhe në interesin e klubit që ta pranojë largimin tim në merkaton e janarit. Jam i bindur që do të bëj një lëvizje për mirë në janar, për të shkuar diku ku të mund të luaj rregullisht", u shpreh Seferi. Me Young Boysin ka qëndruar më së shumti në tribunë, por te Shqipëria Edi Reja e ka marrë në të gjithë grumbullimet dhe shpesh i ka dhënë mundësi të luajë, qoftë edhe si titullar, ndërsa Seferi e ka justifikuar me paraqitjet e mira në fushë. "Trajneri Reja më ka



grumbulluar edhe pse nuk kam luajtur te Young Boys, ndaj i jam mirënjohës. Unë jam munduar ta jap maksimumin dhe të bëj atë që trajneri ka kërkuar prej meje në fushën e lojës. Jam gjithmonë gati për Kombëtaren dhe do të jam 100 % sa herë të më kërkohet", u shpreh Seferi. I pashmangshëm edhe një koment për shortin e eliminatoreve të Kupës së Botës "Katar 2022", që do të startojë në marsin e vitit të ardhshëm dhe sheh kuqezinjtë në të njëjtin grup me skuadra të forta si Anglia e Polonia. "Është një short i vështirë, pasi Anglia është një nga kombëtalet më të mira në botë dhe Polonia është shumë e fortë gjithashtu, por ne kemi treguar shenja rritjeje. Që në Lituani e Kazakistan treguam rritje, por fati nuk deshi të

fitojmë, ndërsa më pas në tre ndeshjet e fundit fituam me meritë dhe zhvilluam lojëra shumë të bukura. Me besim dhe angazhim maksimal, them se do të bëjmë paraqitje dinjitoze edhe në eliminatore", u shpreh sulmuesi. Skuadra e Tiranës i dha fund aventurës evropiane pikërisht nga humbja përballë Young Boysit, një ndeshje të cilën Taulant Seferi e pa nga shkallët e stadiumit, ndërsa nuk ngurroi të komentojë edhe performancën e bardhebluve. "Isha në stadium bashkë me futbollistët e tjerë që nuk ishin grumbulluar për ndeshjen dhe me paraqitjen në 20 minutat e para, Tirana na befasoi të gjithëve. Më pas Young Boysi e rriti nivelin dhe arriti të fitojë", ka deklaruar Seferi.

Messi: Kalova një verë të tmerrshme

Barcelonë, 21 dhjetor - Leo Messi verën e kaluar ishte shumë afër largimit nga Barcelona, por "pleshti" qëndroi në "Camp Nou" dhe ai që u largua ishte Josep Maria Bartomeu, ish-presidenti i klubit katalanas. Ylli argjentinas ndodhet në vitin e fundit të kontratës me Barcelonën dhe tifozët janë në ankth rreth së ardhmes së tij, edhe pse ka shpresa që presidenti i ri i klubit do ta bindë ta rinovojë dhe ta mbyllë karrierën tek ekipi i zezë. "Kam kaluar një verë të tmerrshme, por e kam marrë veten. Edhe fillimi i sezonit ishte i vështirë, por tani ndihem mirë. Kam një dëshirë të madhe për të luftuar për realizimin e objektivave të klubit. E ndiej që Barcelona po kalon një moment të vështirë. Gjithçka që rrethon



klubin është bërë e vështirë, por unë s'e kam humbur entuziazmin aspak", ka thënë Messi.

SHKURT

Renia ia zë vendin Stakoshës

Lazio e mposhti Napolin me rezultatin 2-0 falë golave të Immobiles dhe Luis Alberto. Trajneri i të kaltërve, Simone Inzaghi, pas triumfit për mikrofonin e "Sky Sport", foli edhe për portën, ku gardiani Pepe Reina u aktivizua titullar, duke i zënë vendin prej disa ndeshjesh Thomas Strakoshës. "Duhet të jem i sinqertë, Reina po paraqitet vërtet mirë. Në të njëjtën kohë, Thomas Strakosha sapo kishte kaluar Covid-in dhe unë e nxitova që e aktivizova pa u stërvitur mjaftueshëm, ishte faji im. Momenti i tij do të vijë, ai na ka dhuruar paraqitje të shkëlqyera në katër vjetët e fundit, por tani Pepe është në një formë të shkëlqyeshme dhe nuk do të ishte e drejtë ta ulja në stol në këtë moment. Ai e ka fituar vendin e tij", ka thënë Inzaghi.

Genoa shkarkon trajnerin

Genoa e ka shkarkuar trajnerin Rolando Maran, pas rezultateve jo të mira, ndërsa në vend të tij pritet të emërohet Davide Ballardini. Genoa zë vendin e 19-të në Serinë A pas humbjes 2:0 dje në udhëtim ndaj Beneventos. Genoa është në një seri prej 12 ndeshjeve pa fituar në ligë. "Genoa njofton se ka liruar trajnerin Rolando Maran nga posti i tij. Klubi e falënderon trajnerin dhe stafin e tij për angazhimin", thuhet në komunikatë të Genoas.

Mourinho: Javë me rezultate zhgënjyese

Dy humbje brenda katër ditëve, 2-1 në "Anfield Road" ndaj Liverpoolit dhe 0-2 në shtëpi ndaj Leicesterit, kanë lënë Tottenham Hotspuri plot 6 pikë larg kreut dhe kanë prishur humorin e trajnerit portugez Jose Mourinhos. Tekniku portugez i "Spurs"-ave pranon se nuk ka qenë një javë e mirë në aspektin e rezultateve, por thekson se paraqitja e të tijve nuk ka qenë tërësisht për t'u hedhur poshtë dhe se me pak fat situata mund të ishte ndryshe. "Ndaj Liverpoolit ishim shumë pranë marrjes së një pikë, ndërsa ndaj Leicesterit rezultati është disi i gënjeshtërt, pasi luajtëm mirë dhe me pak fat mund t'i kishim marrë ne tri pikët. Gjithsesi edhe Leicesteri vinte pas rezultateve negative dhe duhet ta pranojë se ishim më të përqendruar sot", ka thënë Mourinho.

Rummenigge: Alaba nga janari mund të negociojë me çdo skuadër

David Alaba nuk do ta rinovojë kontratën me Bayern Munchenin, fakt të cilin e pranoi publikisht drejtori i përgjithshëm i klubit, Karl-Heinz Rummenigge. "Kemi bërë gjithçka për të gjetur një akord. Dëshironim një përgjigje brenda muajit tetor, por Alaba nuk na e dha. Nuk e di nëse do të rikthem të negociojmë, por që nga dita e parë e janarit është i lirë të negociojë me çdo skuadër", ka thënë Rummenigge. Alaba ka një kontratë të vlefshme me Bayernin deri në qershor të 2021-s. Në këto kushte, drejtuesit e Bayernit kërkojnë ta shesin lojtarin që në merkaton e janarit, në të kundërt, në fund të sezonit do të langohej me parametra zero. Barcelona e ka ndjekur prej vitesh austriakun, por nuk përjashtohet as mundësia për një kalim në Premierë Ligë, përkatësisht te Manchester City.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



9 789951 780377



DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kieślowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

AGRON SHALA



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



9 789951 780100

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Komuna e Mitrovicës, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës së riciklimit të mbeturinave në Mitrovicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.01.2021 në ora 10:30 në hapësirat e komunës - në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Mitrovicës në adresën Rr: "Bedri Gjinaj" - Nr.Post: 40000 do të organizohet debat publik nga Komuna e Mitrovicës në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e fabrikës së riciklimit të mbeturinave në Mitrovicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/9662771284?pwd=dXgzVW9BalhS3IKdEVTV1FO NTfVZz09>

Meeting ID: 966 277 1284

Passcode: 112233

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Adelina Xharrahu, e diplomuar në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", shpall të pavlefshme diplomën e studimeve bachelor.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

